



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR



SINDIKATA E PAVARUR E
ARSIMIT TË SHQIPËRISË

Pi. 2735

13.02.2023

KONTRATE - KOLEKTIVE PUNE

Sot më 23/02/2023, në ambjentet e Bashkisë Shkodër, nënshkruhet kjo kontratë kolektive pune ndërmjet :

Punëdhënës :

Bashkia Shkodër, me seli në rrugën 13 dhjetori, nr.1 Shkodër përfaqësuar nga z.Bardh Spahia, në cilësinë e kryetarit të Bashkisë .

Punëmarrës:

Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë, SPASH, përfaqësuar me autorizim nga z.Arian Peraj mbajtës i ID me numër persona G40618138K, me cilësinë kryetarit të Sindikatës së Pavarur të Arsimit Shkodër .


Palët në këtë kontratë konfirmojnë se në procesin e negocimit dhe nënshkrimit të kesaj Kontrate Kolektive janë bazuar në ligjin nr. 7961 datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kontratën Kolektive të Punës nënshkruar midis MASR dhe SPASH për ato dispozita që përbëjnë standarte në shkallë vendi për fitimin dhe ushtrimin e profesionit të mësuesisë.

Në zbatim të kërkesave të këtij kuadri ligjor, përfshirë sidomos nenet 163 e në vijim të Kodit të Punës, pala punëmarrëse depozitoi në institucionin e Bashkisë Shkodër kërkesën për lidhjen e kontratës kolektive, së bashku me dokumentacionin përkatës që vërteton identitetin e punëmarresve dhe provën ligjore të përfaqësueshmërisë sindikale.

Prova e përfaqësueshmërisë sindikale përbëhet nga **Deklaratat Personale** të çdo punonjëseje (mësueseje) të arsimit parashkollor dhe të personelit ndihmës të anëtarësuar në SPASH. **Deklaratat Personale** të anëtarësisë janë depozituar me proces- verbal në administratën e Bashkisë.

Deklaratat Personale të anëtarësisë sindikale janë të përhershme. Ato janë të vlefshme deri në momentin kur i/e anëtarësuari/a del në pension, largohet nga sistemi arsimor ose bën kërkesë me shkrim në sindikatën ku është i/e anëtarësuar për t’u larguar nga sindikata. Një kopje të kërkesës së tërheqjes nga anëtarësimi në sindikatë anëtari i tërhequr e dorëzon edhe në institucionin e Bashkisë, në zyrën ku ruhen deklaratat e anëtarësisë sindikale.

Deklaratat Personale të anëtarësisë sindikale kanë vlerë për përcaktimin nga punëdhënësi të sindikates ose sindikatave më përfaqësuese. **Deklarata Personale**, në mënyrë të shprehur në



tekstin e saj, përbën edhe autorizimin që i punësuarit depoziton pranë punëdhënësit për zbritjen e kuotizacionit sindikal nga paga e tij dhe xhirimin në llogarinë e sindikatës ku është i anëtarësuar.

Në bazë të këtij dokumentacioni provohet se SPASH, përkatësisht seksionet e tyre sindikale në territorin e Bashkisë Shkodër njihen si sindikatat më përfaqësuese në arsimin parashkollor dhe në kategorinë e punonjësve ndihmes të arsimit parauniversitar për Bashkinë Shkodër dhe legjitimohen për të negociuar dhe nënshkruar kontratën kolektive të punës për këta punonjës.

Bazuar në sa më sipër, palët zhvilluan procesin e negocimit dhe, në përfundim të tij, u dakortësuan që të hartojnë këtë kontratë kolektive me përmbajtjen që vijon:

Neni 1

Baza ligjore

Kjo kontratë kolektive bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenet 50-51, në konventat ndërkombëtare të punës nr. 87 dhe 98, në ligjin nr. 7961 datë 12.7.1995 “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në Kontratën Kolektive të Punës nënshkruar midis MASR dhe SPASH.

Neni 2

Fusha e zbatimit të kontratës

Kjo kontratë kolektive i shtrin efektet në personelin mësimor dhe drejtues në arsimin parashkollor si dhe në personelin ndihmës të arsimit publik parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja e kontratës

Kjo kontratë kolektive do të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj deri me 31 dhjetor 2027.


Neni 4

Marrëdhëniet punëdhënës – punëmarrës

4.1 Punëdhënësi dhe punëmarrësi do të angazhohen në një proces dialogu social të vazhdueshëm për reformimin dhe modernizimin e arsimit parashkollor në harmoni me reformimin e gjithë sistemit arsimor parauniversitar, për të siguruar konsolidimin dhe bashkëveprimin e të gjithë niveleve, nga arsimi parashkollor, deri te arsimi i mesëm i lartë.

4.2 Punëdhënësi, në marrëdhëniet ligjore dhe kontraktuale të punës, do të respektojë personalitetin e punëmarrësit dhe do të parandalojë çdo qëndrim që cenon interesat dhe dinjitetin e tij.

4.3 Punëdhënësi dhe përfaqësuesit e tij nuk duhet të ndërhyjnë në organizimin, funksionimin dhe administrimin e sindikatave në institucionet e arsimit parashkollor (kopshtet) dhe në sindikatat e sektorëve ndihmës, të secilës sindikatë nënshkruese të kësaj Kontrate dhe as të bëjnë



diferencime midis tyre duke mbështetur një sindikatë në dëm të tjetrës, ose duke nxitur krijimin e sindikatave të tjera. Rastet e konstatuara dënohen sipas dispozitave të neneve 186 dhe 202, pika 1 e Kodit të Punës.

4.4 Punëdhënësi dhe njësitë vartëse të tij, duhet të venë në dijeni mësueset e arsimit parashkollor dhe punonjësit ndihmës të sistemit të arsimit, të cilët janë anëtarë të SPASH, për cdo plotësim ose ndryshim që i bëhet dosjes së tyre personale.

4.5 Në rast ndryshimi të vendit të punës, pa kërkesën e punëmarrësit, të anëtarëve të sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate, zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Punës, nënshkruar midis MAS dhe SPASH, duke përfshirë edhe ndalimin e transferimit jashtë njësisë administrative.

4.6 Bazuar në nenin 54 të ligjit 69/20012 « Per sistemin arsimor parauniversit në Republikën e Shqipërisë », i ndryshuar, Sindikatat do të jenë pjesëtare të grupeve të vlerësimit dhe vendimarrjes për shpërblimin e punëmarrësve që mbrohen me këtë kontratë.

4.7 Me kërkesën me shkrim të palës punëmarrëse, punëdhënësi dhe sektoret vartës të tij, i informojnë sindikatat me të dhëna zyrtare që lidhen me mjetet ekonomike e financiare nga buxheti i shtetit ose i Bashkisë për arsimin parashkollor dhe punonjësit ndihmës të sistemit të arsimit.

4.8 Në procesin e emrimit, lëvizjes dhe largimit nga puna të mësueseve të arsimit parashkollor, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë dispozitat e neneve 57-60 dhe 72 të ligjit nr. 69/2012, date 21. 06. 2012 « Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë », i ndryshuar, si dhe dispozitat e Kontratës Kolektive të Punës, nënshkruar midis MAS dhe SPASH.

Për punonjësit ndihmës zbatohen dispozitat e neneve përkatëse të Kodit të Punës.

Neni 5


Rritja e cilësisë së mësimdhënies, forcimi i rregullit dhe disiplinës në punë

5.1 Ngritja e vazhdueshme e cilësisë së mësimdhënies, forcimi i rregullit dhe disiplinës në punë, zbatimi me korrektësi nga mësueset dhe drejtueset e institucionit të arsimit parashkollor të normave etike, të akteve normative që miraton dhe nxjerr Ministri i Arsimit dhe Sportit, organet përkatëse të Bashkisë si dhe Kontrata Kolektive e Punës e Nivelit të Parë, është objektiv, përgjegjësi dhe obligim i përbashkët i palëve nënshkruese të kësaj Kontrate.

5.2 Mësueset dhe drejtueset e institucioneve arsimore parashkollore, si dhe personeli ndihmës i sistemit të arsimit, janë të detyruar të respektojnë me përpikmëri kohën e punës dhe zhvillimin me cilësi, sipas programit, të orëve të mësimi. Çdo mungesë ose moskorrektësi ndaj këtyre kërkesave, konsiderohet edhe si shkelje e dispozitave të kësaj Kontrate dhe i nënshtrohet masave disiplinore përkatëse, sic përcaktohet në Kontratën Kolektive të Nivelit të Parë.

5.3 Të dy palët nxitin dhe mbështetin përpjekjet dhe marrjen e masave për rritjen e efektivitetit në punë të cdo mësueseje dhe drejtueseje në arsimin parashkollor. Punonjësi që mungon në punë për arsye shëndëtsore është i detyruar të njoftojë brenda ditës me telefon për gjendjen e tij shëndëtsore dhe brenda 2-3 ditëve të paraqesë tek punëdhënësi raportin mjekësor përkatës.

Neni 6



Kushtet e punës, koha e punës dhe pushimit

6.1 Punëdhënsi dhe njësitë e tij vartëse, në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës për « kushtet e punës të punonjësve », merr përsipër veçanërisht :

a - Të sigurojë kushte normale për zhvillimin e mësimin dhe kohën e qëndrimit në institucionin e arsimit parashkollor të fëmijëve, të garantojë ngrohjen, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e institucionit të arsimit parashkollor, si dhe krijimin e mjediseve sa më bashkëkohore për mësueset dhe fëmijët.

b - Të sigurojë, në ambientet e institucionit, kushtet dhe mjetet e nevojshme higjieno sanitare dhe mjetet e ruajtjes nga zjarri.

c - Të sigurojë transport falas me kushte normale për mësueset dhe fëmijët që e përfitojnë këtë të drejtë, sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.

6.2 Koha e punës për personelin mësimor është jo më shumë se 30 orë në javë, ndërsa për personelin ndihmës 40 orë në javë.

6.3 Personeli mësimor i arsimit parashkollor perfiton leje të pagueshme sipas dispozitave ligjore në fuqi.

6.4 Personeli ndihmës në arsimin parauniversitar perfiton leje të zakonshme vjetore të barabartë me 4 javë kalendarike.

Neni 7

E drejta për informacion dhe ballafaqim

7.1 Punëdhënësi merr përsipër të informojë organet drejtuese sindikale, për problemet që kanë të bëjnë me gjendjen social-ekonomike të punëmarrësve, me masat për zhvillimin e reformes, kushtet e punësimit, lëvizjet e personelit , buxhetin për arsimin etj, që janë në kompetencë të tij dhe që kryhen brenda kuadrit që përcakton Kontrata Kolektive e Nivelit të Parë.

7.2 Të drejtën e kërkesës për ballafaqim e kanë të dy palët. Takimi duhet të organizohet brenda 5 ditëve pas kërkesës me shkrim nga secila palë.

7.3 Palët marrin përsipër që të diskutojnë mbi bazën e përgjegjësisë, korrektësisë dhe rregullimit ligjor, duke i dhënë prioritet zgjidhjes së problemeve e shqetsimeve me dialog.

Neni 8


Kualifikimi

8.1 Kualifikimi i vazhdueshëm është detyrë dhe e drejtë e të gjithë mësuesëve të arsimit parashkollor, gjatë gjithë kohës së marrëdhënieve të punës.

8.2 Bazuar në nenin 58 të ligjit 69/2012, datë 21. 06. 2012, punëdhënësi, në bashkëveprim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, merr përsipër trajnimin profesional të personelit të arsimit parashkollor, sipas nevojave të tyre, për jo më pak se tre ditë në vit.

8.3 Dëshmitë e kualifikimeve duhet të evidentohen në dosjet personale dhe të jenë tregues për vlerësimet dhe emërimet e punëmarrësve.

Neni 9



Liritë dhe të drejtat sindikale

9.1 Punëdhënësi, në zbatim të Nenit 181 të Kodit të Punës, si dhe të Kontratës Kolektive të Nivelit të Parë, garanton dhe respekton liritë dhe të drejtat sindikale në përgjithësi dhe në nivelin vendor vecanërisht :

9.2 Në çdo institucion të arsimit parashkollor dhe në cdo njësi të sektorëve ndihmës të arsimit sindikatat kanë të drejtë të organizohen, të bëjnë mbledhje dhe të zhvillojnë aktivitete, pa cënuar kohën e punës dhe procesin mësimor.

9.3 Për aktivitete që organizojnë sindikatat në nivel qendror apo vendor, kryetari i secilës sindikatë në nivel institucioni parashkollor apo njësie ndihmëse gëzon 1 ditë leje të pagueshme në muaj, por jo më shumë se 9 ditë në vit, për të marrë pjesë në këto aktivitete. Kërkesa i paraqitet punëdhënësit nga pala punëmarrëse nënshkruese e kësaj Kontrate të paktën 3 ditë para aktivitetit.

9.4 Në bordin e institucionit arsimor parashkollor marrin pjesë edhe kryetari ose kryetarët e sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate që përfaqesojnë më shumë se 10 anëtarë.

9.5 Për zhvillimin e aktiviteteve të sindikatave, punëdhënësi siguron ambiente pune. Salla e mbledhjeve për të dy sindikatat do të jetë në ambjentet e institucionit arsimor ose të njësisë së sektorit ndihmës.

9.6 Kryetari i SPASH për arsimin parashkollor nën juridiksionin e Bashkisë Shkodër, për të mundësuar marrjen me veprimtari sindikale mbështetur në nenin 181(7) të Kodit të Punës, i reduktohet ngarkesa mesimore javore me 10 ore mesimore.

9.6 Mbështetur në nenin 181, pika 7 e Kodit të Punës dhe të Kontratës Kolektive të Nivelit të Parë, sektori ekonomik dhe i finances i punëdhënësit zbrit nga paga e cdo sindikalisti kuotizacionin sindikal në shumën e përcaktuar nga SPASH. Ndajësia bëhet në periudha të caktuara, sipas kërkesës së sindikatave qendrore dhe xhirohet në llogaritë e tyre.

Neni 10

Dispozita të vecanta

10.1 Çdo punëmarrës ka të drejtë, që me kërkesën e tij, të informohet për elementët e pagës, si për ndalesat, ashtu edhe për shtesat.

10.2 Sindikalistët anëtarë të SPASH, kur dalin në pension, përfitojnë një shpërblim të menjëhershëm në masën e një page mujore neto. Shpërblimi jepet vetëm me autorizim me shkrim të titullarëve të sindikatave qendrore.

10.3 Pala punëdhënëse merr përsipër njohjen me këtë Kontrate Kolektive të punonjësve të arsimit parashkollor dhe sektorëve ndihmës të arsimit në juridiksionin e saj, duke e ekspozuar në vend të dukshëm në ambjentet e cdo institucioni parashkollor dhe të punonjësve ndihmës të saj.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve



11.1 Palët bien dakort që, kur Kontrata Kolektive nuk zbatohet ose shkelet nga njera palë, do të bëhen përpjekje të përbashkëta që mosmarrveshja të zgjidhet me mirëkuptim, nëpërmjet rrugës së bisedimeve dypalëshe. Nëse kjo nuk arrihet, pala e dëmtuar i drejtohet Gjykatës, duke kërkuar zbatimin e neneve 170 dhe 202 të Kodit të Punes.

Neni 12

Depozitimi


Kjo Kontratë hartohet në tre kopje te barazvlefshme, nga të cilat një kopje ruhet në arkivin e Bashkisë Shkodër, nga një kopje për sindikaten nënshkruese dhe një kopje depozitohet ne Zyrën e Punësimit të Qarkut.

Pala punëdhënëse:

Përfaqësuesi i Bashkisë

KRYETAR

Bardh SPAHIA



Pala punëmarrëse:

Përfaqësuesi me autorizim i SPASH Shkodër

KRYETAR

Arian PERAJ

A handwritten signature in black ink, which appears to read "Arian PERAJ", is written below the printed name.